



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 2063/1 Prot.

Tiranë, më 19.11.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1495, datë 02.09.2010.

SHOQËRISË “ALBANIAN MINERALS” SH.P.K  
Fshati Pac, Njesia administrative Bytyç, Tropojë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “ALBANIAN MINERALS” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1495, datë 02.09.2010, për mineralin Krom, në objektin “Vlad-2”, Tropojë, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.887, datë 22.02.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.2063, Prot, datë 23.02.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1495, datë 02.09.2010, për mineralin Krom, në objektin “Vlad-2”, Tropojë, Qarku Kukës, sepse nuk keni respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesat e garancive financiare të rehabilitimit për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.1495, datë 02.09.2010, për mineralin Krom, në objektin “Vlad-2”, Tropojë, Qarku Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1495, datë 02.09.2010, për mineralin Krom, në objektin “Vlad-2”, Tropojë, Qarku Kukës.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

